

Letërnjoftimi i Komunës së

# DRAGASHIT

# 2014

Maj, 2015





## Fakte


- Të hyrat buxhetore të Komunës së Dragashit më 2014 kanë shënuar një ngritje të lehtë në krahasim me një vit më parë. Të hyrat më të mëdha janë nga tatimi në pronë 39,2%, ndërsa 26,6% janë nga taksat dhe 15,4% janë të hyra nga shitja e pasurisë dhe shërbimet.
- Në administratë komunale janë të punësuar 163 persona, apo një shërbyes civil për 210.8 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Komuna e Dragashit ka rritur numrin e punonjësve në sektorin publik. Krahasuar me një vit më herët është rritë numri i të punësuarve në sektorin e administratës për 14 punonjës dhe në arsim për 27 punonjës.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 516 persona, prej tyre 384 mësimdhënës. Në Komunën e Dragashit raporti nxënës/mësimdhënës është 13.5. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 114 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Dragashit është 301.4. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Numri i banorëve në Dragash është 34.363, gjatë vitit 2014 ka pasur 1.378 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Dragash rreth 4% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Agjensionin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës janë të regjistruara 1.396 biznese nga Komuna e Dragashit. Nga ky numër veprimtari prodhuese ushtrojnë 161 biznese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 73 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 33 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Dragashit, Salim Jenuzi në vitin 2013 e fitoj mandatin e tretë për ta udhëhequr Komunën e Dragashit. Gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 19 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 15%, apo nën mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

## 2 Qeverisja komunale

Komuna e Dragashit në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka rizgjedhur për herën e tretë kandidatin e PDK-së Salim Jenuzin, duke e fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes tij dhe Fatmir Mehmeti nga radhët e LDK-së.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 15,252 apo rreth 40% e qytetarëve me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Salim Januzi ka marr 60%, ndërsa Fatmir Mehmeti ka marr 40% të votave.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 8 ulëse, LDK 7 ulëse, CDU 4, Vakati 3 ulëse, koalicioni AAK-LDD dy ulëse, Bashkimi Demokratik dhe AKR nga nja ulëse.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Dragashit në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Dragashit ka 8 drejtori komunale. Pas zgjedhjeve, Kryetari Salim Jenuzi ka arritur marrëveshje me VAKAT për bashkëqeverisjen e komunës.

### 3 Buxheti i Komunës së Dragshit


Më 2014, Komuna e Dragshit kishte buxhet prej 6,6 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje 3,8 milion për të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 2.2 milion euro, një rritje e lehtë në krahasim me dy vitet paraprake.

**Grafikoni nr. 3** Buxheti total i Komunës së Dragshit dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Dragshit janë afro 374 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2013.

**Grafikoni nr.4** Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Dragshit 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 40% të të hyrave të përgjithshme.

**Grafikoni nr.5** Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunit tjetra të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Dragashit ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna e Shtimes, Hani i Elezit, Shtërpca, Novobërda etj. Ndërsa më pak se sa Malisheva, Kaçaniku, Deçani etj.

**Grafikoni nr.6** Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona fikse, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie të lehtë në krahasim me një vit më parë, ndërsa për telefoni mobile është një rritje e lehtë për 1.500 euro më shumë se sa një vit më herët, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

**Grafikoni nr. 7** Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Dragashit gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për mbeturina rreth 33,879 mijë euro, apo 6,805mijë euro më shumë krahasuar me një vit më herët.


**Grafikoni nr. 8** Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



## 4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Dragashi e ka përmbyllur me 776 të punësuar në sektorin publik, ky numër është i rritur për 46 të punësuar më shumë se viti 2013. Përgjatë këtij viti, janë punësuar 14 shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës, 27 punonjës në sektorin e arsimit dhe 5 në shëndetësi.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Dragashit



Dragashi ka të punësuar një shërbyes civil për 210,8 banorë. Në krahasim me komunitat tjera, Dragashi ka më shumë të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.


Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori






Në sektorin e arsimit janë të punësuar 516 persona, prej tyre 473 mësimdhënës. Në Komunën e Dragashit raporti nxënës/mësimdhënës është 13,5. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Në sektorin e arsimit, Dragashi ka të punësuar më shumë staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

**Grafikoni nr.11** Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Dragashit



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 114 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Dragashit është 301,4. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


**Grafikoni nr.12** Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale


Në Komunën e Dragashit janë 1.396 biznese të regjistruara. 161 biznese janë biznese prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 114 biznese të reja, 209 në 2013 dhe 111 në 2012. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.

**Grafikoni nr.13** Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 39 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

**Grafikoni nr.14** Llojet e bizneseve të shuara më 2014



## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Salim Jenuzi gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 19 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z. Jenuzi ka arritur të realizoj 15% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

**Grafikoni nr.16** Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

